



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, 05 korrik 2012  
Nr.Ref.RK264/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI-37/10**

**Nebojša Stanojević, Dragan Marinković dhe 118 ish të punësuarit „N.SH. Banja e Kllokotit“**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme Nr. SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006 dhe Aktvendimit Nr. SCEL 06-016 të datës 31 janar 2007**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almira Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Cukalovic, gjyqtar  
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

## Parashtruesit e kërkesës janë:

1. **Stanojević Nebojša,**
2. **Marinković Dragan**
3. Bukelić Miodrag
4. Bocić Aleksandar
5. Cvetković Petar,
6. Simić Ilija
7. Spasić M. Slobodan
8. Stoilković Trajan
9. Perić Ljubiša,
10. Stojanović Zoran,
11. Raković Novica
12. Perić Đoka
13. Nedeljković Milan
14. Tomić Trajan
15. Tomić Vesna
16. Zdravković S. Zoran
17. Nojković Vlasta
18. Bojić Stanimir
19. Zdravković Miroslava
20. Zdravković Nenad
21. Trajković M. Zoran
22. Cvetković (Marković) Deska
23. Marinković Slobodan
24. Ivković Srđan
25. Zdravković Dobri
26. Stanković Dušica
27. Antić Dragan
28. Spasić Milić
29. Vesić Ilija
30. Svilanović Stanislav
31. Mirković Zoran
32. Vesić Nataša
33. Spasić Mića
34. Aksić Živojin
35. Stojković Ivan
36. Radić Tihomir
37. Vasić P. Srećko
38. Stolić Miodrag
39. Vlajković Milan
40. Zdravković Živko
41. Cvetković Dragoljub
42. Marković Rodobljub
43. Milkić (Spasić) Slađa
44. Vesić (Simić) Biserka
45. Vasić B. Srećko
46. Vasić Bocka
47. Tomić Svetlana
48. Cvetković Trajan
49. Bogdanović Srđan
50. Nisić Ljubomir
51. Spasić Jadran
52. Spasić Boban
53. Cvetković Momčilo
54. Spasić Zoran
55. Vlajković Staniša
56. Mirković Nikola
57. Bogdanović Zvonko
58. Kecić Bogoslav
59. Dimić Čedomir
60. Kecić (Arsić) Blagica
61. Dimić Dobrila
62. Mirković Dragan
63. Simić Zoran
64. Vesić Lj. Srđan
65. Radić Ivica
66. Stolić Vesna
67. Radić Nenad
68. Savić Petar
69. Jovanović Ivica
70. Cvetković Božidar
71. Nojkić Tomislav
72. Stoilković Zoran
73. Zdravković V. Zoran
74. Svilanović Nenad
75. Marinković Trajko
76. Marinković Saša
77. Vesić Olga
78. Kojić Nenad
79. Spasić Dragan
80. Nisić Ivan
81. Marinković Srećko
82. Marinković Vesna
83. Marinković ( Kojić) Radmila
84. Kojić Tomislav
85. Vesić M. Srđan
86. Trajković Nebojša
87. Ristić (Maksimović) Mileva
88. Spasić J. Slobodan
89. Stević Vesko
90. Jovanović Svetlana
91. Maksimović Dragan
92. Stanković Jelena
93. Stoilković Ivica
94. Pavić Zoran
95. Pavić Jovan
96. Mitić ( Pavić) Sunčica
97. Savić Leposava
98. Zafirović (Stanković) Slobodanka
99. Tomić Zoran
100. Spasić Bogdan
101. Mikilić (Dinčić) Vesna
102. Savić Olivera
103. Stojanović Svetomir
104. Đorđević Žarko
105. Dimić Jadran
106. Zafirović Miodrag
107. Zafirović Todor
108. Stanković Srebrena
109. Vesić Ljubiša
110. Vasić (Cvetković) Snežana
111. Perić Slobodan
112. Bogdanović Milivoja
113. Bogdanović (Spasić) Radica
114. Cvetković T. Slobodan
115. Stanković Vlasta
116. Đorić Jovica
117. Arsić Nenad
118. Jovanović Slavica
119. Stanković Nebojša
120. Mirković Milorad

1. Në këtë raport, për hir të raportimit më të lehtë parashtruesit e kërkesës janë të listuar dhe kolektivisht mund të quhen, si: Nebojša Stanojević, Dragan Marinković dhe 118 ish të punësuarit e Ndërmarrjes Shoqërore Banja e Klokotit nga Klokoti. Në procedurat para Gjykatës Kushtetuese ata përfaqësohen nga Nebojša Stanojević dhe Dragan Marinković.

## **Vendimet e kontestuara**

2. Kontestohen dy vendime të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM)
  - a) Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet lidhur me AKM nr. SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006 si dhe
  - b) Aktvendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet lidhur me AKM nr. SCEL 06-016 të datës 31 janar 2007.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesit e kërkesës i kontestojnë vendimet e lartpërmendura të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme duke mos përmendur ndonjë nen konkret të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Kushtetuta"). Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është bërë shkelje e të drejtës në fushën e marrëdhënieve të punës (e drejta në kompensim prej 20% në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore).

## **Baza juridike**

4. Nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejme: "Ligji") dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Rregullorja e Punës").

## **Procedura para Gjykatës Kushtetuese**

5. Parashtruesit e kërkesës më 2 qershor 2010 e parashtruan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Gjykata").
6. Më 4 prill 2011, Gjykata Kushtetuese me shkresën Nr.ref:649/11/r.l. ka kërkuar nga AKM dokumentacion dhe sqarime shtesë lidhur me procedurat e zbatuara me rastin e publikimeve në gjuhën serbe.
7. Më 25 maj 2011, AKM së bashku me përgjigjen Nr.10/1 ka dorëzuar edhe udhëzimin e dhënë më 2004 nga ana e zyrës ligjore të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (në tekstin e mëtejme:PSSP), si dhe listën e plotë të punëtorëve që i plotësojnë kushtet për të drejtën në pjesën e mjeteve nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore Banja e Kllokotit nga Kllokoti.
8. Më 19 qershor 2012, pas shqyrtimit të Raportit paraprak të gjyqtares Iliriana Islami, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Prof. dr. Ivan Čukalović dhe Mr. sc. Kadri Kryeziu, i propozoi gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve**

9. Ndërmarrja Shoqërore Banja e Kllokotit (në tekstin e mëtejme: NSH Banja e Kllokotit) përbëhet nga dy njësi punuese:
  - a) njësia punuese Fabrika e Ujit Mineral në Kllokot, dhe
  - b) njësia punuese Stacionari (Qendra për Shërim dhe Rehabilitim) gjithashtu në Kllokot.

10. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe plotësimeve në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45 me rastin e privatizimit të pjesës së parë NSH Banja e Kllokotit njësia punuese Fabrika e Ujit Mineral që është kryer më 24 nëntor 2005 AKM e ka përcaktuar listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet të cilëve sipas Rregullores u takon pjesa e 20% të mjeteve nga privatizimi i NSH Banja e Kllokotit.
11. Lista e punëtorëve që i plotësojnë kushtet është publikuar në të përditshmet në gjuhën shqipe *Zëri dhe Koha Ditore* më 28 dhe 29 qershor dhe më 1 korrik 2006, përderisa në gjuhën serbe lista e punëtorëve që i plotësojnë kushtet është publikuar më 28 dhe 29 qershor e 1 korrik 2006 në të përditshmet *Danas dhe Blic*.
12. Së bashku me listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet, të cilëve ju takon pjesa e 20% të mjeteve nga privatizimi, është publikuar edhe udhëzimi lidhur me mjetet ligjore për punëtorët që nuk janë përfshirë në listën e publikuar, të cilët kanë pasur mundësinë t'i paraqesin ankesë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit të paraparë prej 20 ditësh i cili ka skaduar më 24 korrik 2006.
13. Një numër i madh i punëtorëve, të cilët nuk ishin përfshirë në listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet nga ana e AKM-së, iniciuan procedurë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që kanë të bëjnë me AKM, në mënyrë që të përfshiheshin në listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet.
14. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me AKM-në, për të gjitha ankesat e parashkruara vendosi me Aktgjykimin nr. SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006, me të cilin urdhëron që AKM të përfshijë 12 (dymbëdhjetë) punëtorë në listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet dhe me të njëjtin aktgjykim hedh poshtë kërkesat e 8 (tetë) punëtorëve si **të pabaza**, ngaqë nuk kishin plotësuar kushtet e parapara me Rregullore për përfshirje në listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet.
15. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me AKM-në për të gjitha ankesat e parashkruara vendosi me Aktvendimin nr. SCEL 06-016 të 31 janarit 2007, me të cilin Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme i hodhi poshtë ankesat e 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) punëtorëve si **të parashkruara** për shkak se janë parashtruar pas 24 korrikut 2006, kur kishte kaluar afati i paraparë për parashtrimin e ankesave.
16. Me të njëjtin vendim Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme vëren se ekziston një numër i madh i ankesave të dorëzuara pas afatit të paraparë me ligj dhe sugjeron se lista punëtorëve që i plotësojnë kushtet ndoshta nuk është shpallur në mënyrë të efektshme dhe prandaj këshillon "*që de jure condendo të bëhet një qarkullim më efektiv dhe me përhapje më të gjerë të listës së punëtorëve që i plotësojnë kushtet në mesin e palëve mund të jenë potencialisht të dëmtuara*".
17. Më 13 prill 2010 është nënshkruar marrëveshja për privatizimin e pjesës së dytë të NSH Banja e Kllokotit - njësia punuese Stacionari (Qendra për Shërim dhe Rehabilitim), e shpërndarja e mjeteve të 20% është bërë sipas listës së punëtorëve që i plotësojnë kushtet të konfirmuar më parë nga ana e AKM-së dhe miratuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme me Aktgjykimin Br.SCEL-06-0016 të 10 tetorit 2006.
18. Më 15 prill 2010 parashtruesit e kërkesës iu drejtuan me shkrim AKM-së me kërkesën që për pjesën e dytë të NSH Banja e Kllokotit njësia punuese Stacionari (Qendra për Shërim dhe Rehabilitim) duhet të përcaktohet lista e re e punëtorëve që i plotësojnë kushtet dhe kërkojnë që AKM t'i përfshijë parashtruesit e kërkesës në procesin e shpërndarjes së aksioneve të pjesës së dytë të ndërmarrjes.

19. Më 29 tetor 2010 në përgjigjen ndaj kërkesës për përfshirje në listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet, AKM-ja thekson se nuk mund t'i përfshijë parashtruesit e kërkesës në listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet ngase lista e punëtorëve që i plotësojnë kushtet është përcaktuar me rastin e privatizimit të pjesës së parë të NSH Banja e Klllokotit - njësia punuese Fabrika e Ujit Mineral.
20. Në vazhdim të përgjigjes së vet AKM pohon se me rastin e përcaktimit të listës së punëtorëve që i plotësojnë kushtet, AKM ka vepruar në pajtim me udhëzimin e dhënë në vitin 2004 nga ana e zyrës ligjore të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, në të cilin thuhet se "... nëse një ndërmarrje ka disa njësi organizative, atëherë lista e përbashkët bazohet në të gjitha njësitë organizative ndërsa data zyrtare e privatizimit konsiderohet data e privatizimit të pjesës së parë të asaj ndërmarrjeje."
21. Në fund AKM thekson se lista përfundimtare e punëtorëve që i plotësojnë kushtet përcaktohet sipas aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme Nr.SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006, dhe se ai aktgjykim është i formës së prerë, detyrues dhe se kundër tij nuk mund të parashtrohet asnjë ankesë.

#### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me AKM-në nr. SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006 dhe me Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me AKM-në nr. SCEL 06-016 të datës 31 janar 2007 i janë shkelur të drejtat në fushën e marrëdhënieve të punës.
23. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se janë dëbuar nga puna në periudhën Korrik-Gusht 1999 për shkak të diskriminimit etnik, se kurrë nuk i kanë marrë aktvendimet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, se edhe pse i kanë plotësuar kushtet prej 3 e më shumë vjetësh përvojë pune, janë përjashtuar nga lista e punëtorëve që i plotësojnë kushtet për shkak të diskriminimit etnik.
24. Më tutje parashtruesit e kërkesës pohojnë se nuk kanë mundur të dorëzojnë brenda afatit të paraparë ankesat ndaj vendimit të AKM-së pasi që nuk kanë qenë të informuar në gjuhën serbe dhe si dëshmi e bashkëngjisin vërtetimin e "RADIO KLLOKOTIT" si të vetmin burim të informimit në gjuhën serbe në komunën e Klllokotit ku thuhet se ky radio stacion kurrë nuk kishte bërë një lajmërim të popullatës për privatizimin e NSH Banja e Klllokotit.
25. Njëkohësisht parashtruesit e kërkesës pohojnë se të përditshmet Danas dhe Blic nuk janë të përditshme që publikohen në Republikën e Kosovës, kështu që nuk ekzistojnë në territorin e komunës së Klllokotit.

#### **Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë**

26. Në mënyrë që kërkesa të jetë e pranueshme, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse Parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligjin dhe Rregulloren e Punës të Gjykatës Kushtetuese.
27. Sa i përket kërkesës së parashtruesve të kërkesës Gjykata i referohet rregullit 36. paragrafi 3 pika h) që parasheh:

*„Një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese:*

h) kur

28. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit e kanë dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 2 qershor 2010, përderisa vendimi i fundit në lidhje me këtë rast, pra aktvendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me AKM Nr. SCEL 06-016 është marrë më 31 janar 2007. Kjo do të thotë se kërkesa ka të bëjë me ngjarje para 15 qershorit 2008, respektivisht para hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
29. Në bazë të kësaj, kërkesa nuk është “*ratione temporis*” në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit (shih *mutatis mutandis* Blečić kundër Kroacisë, kërkesa nr. 59532/00, *Aktgjykimi* i GJEDNJ-së, 29 korrik 2004), prandaj përfundohet se kërkesa është e vjetruar.
30. Rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme sipas rregullit 36 (3h) të Rregullores së Punës i cili parasheh: „*Një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese: h) kur kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën.*“

#### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 36 (3h) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 19 qershor 2012, me shumicë votash

#### VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtar Raportues**



Dr. Iliriana Islami

**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani